




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E SHITES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje /Department of Education

Nr. i Protokollit: 05/293

Datë: 5. 6. 2024

Duke u bazuar në nenin 62, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, bazuar në Ligjin Nr.02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor, në Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, në Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, në bazë Rregullores për Organizimin e Punës në Arsimin Parauniversitar

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR "ALBIONA ASLLANI" PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025

Regjistrimi i fëmijëve në Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" në Shtime, do të bëhet duke u bazuar në Kriteret e Regjistrimit të përcaktuara nga DKA përmes vendimit nr.prot.05/291 të datës 4. 6. 2024, i cili do të bashkëngjitet këtij konkursi.

Vendet e lira për regjistrim në Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" për vitin shkollor 2024/2025

Nr. i klasave	Grupmoshat	Nr i fëmijëve
1 klasë (dhomë)	Grupi i Çerdhes 09 muaj – 2 vjeç	10 fëmijë
1 klasë (dhomë)	Grupi i Çerdhes 2-3 vjeç	1 fëmijë
1 klasë (dhomë)	Grupi i Kopshtit 3-4 vjeç	23 fëmijë
1 klasë (dhomë)	Grupi i Kopshtit 4-5 vjeç	2 fëmijë
1 klasë (dhomë)	Grupi Parafillor 5-6 vjeç	24 fëmijë
Totali		60 fëmijë

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

- Ekstrakti i lindjës së fëmijes (kopje);
- Libreza e imunitetit / vaksinimit (kopje);
- Dëshmia nga mjeku (mjeku peditër ose mjeku familjar), për gjendjen shëndetësore të fëmijës (origjinale);
- Kontratat e prindërve që janë në marrëdhënie pune së bashku me pasqyrën e trustit për 6 mujorin e fundit (kopje);
- Faturë e shërbimeve komunale, jo më të vjetër se gjatë muaj.

Adresa: Rr. "Tahir Sinani" nr. 50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes **5. 6. 2024** deri më datë **19. 6. 2024**

Aplikacioni dhe gjithë dokumentacioni i nevojshëm merren dhe dorëzohen çdo ditë pune në Objektin e Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" në Shtime nga ora **9:00** deri në ora **15:00**

Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysht për shqyrtim

Duke u bazuar në nenin 5, pika 5 e Udhëzimit Administrativ të MASHT Nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë i cili e përcakton raportin edukator-fëmijë për grupmoshën 5-6 vjeç, i cili është 2/24 ose më së shumti 2/26, nëse nuk arrihet numri i mjaftueshëm sipas udhëzimit, klasa nuk do të ketë mundësi që të formohet, në rastin eventuale të mosarritjes së formimit të kësaj grupmoshe, do të krijohet një dhomë/klasë me grupmoshën nga e cila do të ketë më së shumti kërkesa.


Shpallja e rezultateve do të bëhet më datë **28. 6. 2024** në Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" dhe në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Drejtoresha e DKA-së,
Yllka Fejzullahu





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje/Department of Education

Nr. i Protokollit:05/291

Datë:04.06.2024

Duke u bazuar në nenin 62, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, bazuar në Ligjin Nr.02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor, në Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, në Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, drejtoresha e DKA-së merr:

VENDIM

**PËR KRITERET E PRANIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONIN
PARASHKOLLOR "ALBIONA ASLLANI" NË SHTIME PËR VITIN SHKOLLOR
2024/2025**

Të gjithë fëmijët e prindërve banorë të komunës së Shtimes dhe ata të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë vendim nga mosha 09 muaj deri 5 vjeç mund të regjistrohen në Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani". Fëmijët e komunave tjera mund të regjistrohen vetëm atëherë kur nuk plotësohet numri i fëmijëve në institucionin e sipërpërmendur.

Planifikimin e numrit të fëmijëve që do të pranohen në Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" e bën vet institucioni në fjalë, në përputhje me infrastrukturën ligjore, kapacitetet fizike dhe profesionale.

Moshën e fëmijëve dhe grup-moshat i përcakton vet Institucioni Parashkollor "Albiona Asllani", në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kapacitetet fizike e profesionale. Llogaritja e moshës bëhet në bazë të datës së fillimit të marrjes së shërbimit e jo me rastin e regjistrimit

Pranimi i fëmijëve do të bëhet në bazë të numrit të pikëve të grumbulluara sipas kriterëve të poshtëshënuara në tabelë:

Nr	Kategoria/ Kriteri	Pikët
01	Fëmijët me të dy prindërit e punësuar	100
02	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	95
03	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
04	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	85
05	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	80

06	Fëmijët e nënave vetushqyese (nëse nëna është e punësuar)	75
07	Fëmijët me nevoja të veçanta (të lehta) nëse të dy prindërit punojnë	70
08	Fëmijët me njërin prind të punësuar (me përparësi nëna e punësuar)	65
09	Fëmijët me njërin prind të punësuar (babai i punësuar)	60
10	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	55
11	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	50
12	Fëmijët me nevoja të veçanta (të lehta) nëse njëri prind punon	45
13	Fëmijët e nënave vetushqyese (nëse nëna është e punësuar)	40
14	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i papunësuar	35
15	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	30
16	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	25
17	Fëmijët me nevoja të veçanta (të lehta) nëse asnjëri prind nuk punon	20
18	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar nuk punon	15
19	Fëmijët me të dy prindërit me nevoja të veçanta	10
20	Fëmijët me të dy prindërit e papunësuar	5

Vërejtje: Të gjitha kategoritë e përfshira në tabelën e sipërme, duhet të dëshmojnë me dokumente valide nga institucionet përkatëse statusin e tyre.

